



Njoftim

“Për procedurën e përjashtimit nga pagesa e tarifës së shkollimit për studentët që ndjekin studimet në ciklin I Bachelor, viti II dhe III, me kohë të plotë, për vitin akademik 2016-2017”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 699, datë 22.10.2014 “Për përjashtimin ose reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit e studentëve që ndjekin programet e studimeve me kohë të plotë të ciklit të parë, programet e studimeve jouniversitare, profesionale, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura” në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2014 – 2015; VKM Nr. 638, datë 22.7.2015 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 – 2016” dhe VKM Nr.866 datë 23.10.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 638, datë 22.7.2015 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 – 2016”; Shkresa e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nr 226/1 prot, datë 18.01.2017;

Njoftojmë se :

Studentët që studiojnë në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në ciklin I Bachelor, viti II dhe III, me kohë të plotë, dhe vijnë nga shtresat sociale të mëposhtme:

1. Personat që nuk shikojnë / dëgjojnë;
2. Invalidët e punës dhe fëmijët e tyre;
3. Invalidët;
4. Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre;
5. Jetimët;
6. Studenti, të cilit njëri nga prindërit i është ndarë nga jeta dhe familja e tij përfiton ndihmë ekonomike nga njësitë e qeverisjes vendore;
7. Romët;
8. Ballkano – egjiptianët;
9. Ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist ose fëmijët me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
10. Fëmijë të policëve e të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, si dhe fëmijët e punonjësve të Gardës së Republikës, të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të punonjësve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, kur punonjësit kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës;
11. Të prekurit nga HIV-AIDS;

Formulari i aplikimit “PRAKTIKË PËR PËRJASHTIM TË PLOTË OSE REDUKTIM NGA TARIFA E SHKOLLIMIT” gjendet në web – site: w.uniel.edu.al rubrika Informacione / njoftime dhe të shkarkohet nga kjo adresë.

Dokumentacioni i përgatitur sipas formularit përkatës të dorëzohet nga vetë studenti në Rektorat deri më datë **16.02.2017**.